



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË

Numri i lëndës: 2024:093332
Datë: 31.05.2024
Numri i dokumentit: 05762584

C.nr.590/2024

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË - Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni Civil, gjyqtari Besmir Juniku, në çështjen juridike të paditëses J.K., nga Gjakova, të cilën me autorizim e përfaqëson Av.Arben Biblekaj nga Prishtina, kundër të paditurës Komuna e Gjakovës – Drejtoria Komunale e Arsimit, të cilën me autorizim e përfaqëson zyrtarja ligjore Q.-B-H., për shkak të kompensimit të ushqimit gjatë ditëve të punës, vlera e kontestit 374.00€uro, jashtë shqyrtimit, me datë 31.05.2024 merr këtë:

A K T G J Y K I M

I.APROVOHET si e bazuar kërkesëpadia e paditëses J.K., nga Gjakova, ashtu që DETYROHET e paditura Komuna e Gjakovës – Drejtoria Komunale për Arsim, që paditëses në emër të kompensimit të shpenzimeve të ushqimit në punë t'ia paguaj shumën prej 374.00 (treqind e shtatëdhjetë e katër) €uro, për 187 ditë të vajtjes në punë, për periudhën prej datës 05.11.2021 e deri me datë 21.11.2022, duke llogaritur me nga 2.00 (dy) €uro, për secilën ditë të punës, me kamatë prej 8%, duke filluar nga dita e ushtrimit të padisë (datë 23.02.2024), e deri në pagesën përfundimtare, të gjitha këto në afat prej 7 (shtatë) ditësh, nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi, me pasojat ligjore përmbarimin e detyrueshëm.

II.DETYROHET e paditura Komuna e Gjakovës – Drejtoria Komunale për Arsim, që në emër të pagesës për shpenzimet e procedurës, paditëses t'ia paguaj shumën prej 98.00€uro, në afat prej 7 ditësh, nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi nën kërcënimin e përmbarimit të detyrueshëm.

A r s y e t i m

Paditësja Jehona Kumnova Dula nga Gjakova, përmes të autorizuarit të saj Av.Arben Biblekaj nga Prishtina, në këtë gjykatë me datën 30.01.2024 ka parashtruar padi për shkak të kompensimit të ushqim gjatë ditëve të punës, kundër të paditurës Komuna e Gjakovës – Drejtoria Komunale e Arsimit.

Paditësja përmes të autorizuarit të saj Av. Arben Biblekaj nga Prishtina në padi ka theksuar se është e punësuar tek e paditura në bazë të kontratës së punës në Shkollën Fillore të Mesme të Ulët “...” në Gjakovë. Duke shtuar se paditësja i plotëson kushtet e përfitimit të shujtës ditore sipas kushteve të parapara me nenin 35 par. 7 të Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë, të nënshkruar në mes të Ministrisë së Arsimit dhe SBASHK-ut dhe atë me nga 2 euro për secilën

ditë të pranisë në punë e që për periudhën prej datës 05.11.2021 e deri me datë 21.11.2022, për 187 ditë të vajtjes në punë i takojnë 374.00euro. Gjykatës i ka propozuar që kërkesëpadinë ta aprovojë në tërësi si të bazuar dhe ta detyroj të paditurën Komuna Gjakovë-DKA që paditëses t'ia kompensoj shpenzimet e ushqimit për periudhën nga data 05.11.2021 e deri me datë 21.11.2022 në vlerën prej 374 euro, me kamatë ligjore prej 8% nga momenti i parashtrimit të padisë. Shpenzimet e procedurës i ka kërkuar sipas tarifës së OAK-së në vlerën prej 98.00, për padi dhe taksë.

E paditura përmes të autorizuarës së saj Q.B-H., në përgjigje në padi ka theksuar: e kontestoj padinë si të pabazuar, ngase e paditura nuk është nënshkruese e marrëveshjes kolektive. Këto marrëveshja janë nënshkruar nga MASHT dhe SBASHK-u dhe detyrimet nuk bien mbi të paditurën. MASHT ka marrë obligim që të siguroj mjetet financiare për zbatimin e këtyre kontratave kolektive dhe këtë nuk e ka realizuar. Prandaj kërkesëpadia e palës paditëse është e pabazuar. Po ashtu kërkesa është parashkruar konform nenit 87 të Ligjit të Punës.

Gjykata pas shqyrtimit të padisë, provave që gjenden në shkresat e lëndës, si dhe përgjigjes në padi të paraqitur nga ana e të paditurës, në kuptim të nenit 8 lidhur me nenin 398 të LPK-së, gjeti se kërkesëpadia e paditëses është në tërësi e bazuar, andaj pa shqyrtim të çështjes, vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Ndërmjet palëve ndërgjyqëse nuk është kontestues fakti se paditësja është në marrëdhënie pune në pozitën mësimdhënëse tek e paditura, përkatësisht në Shkollën Filllore të Mesme të Ulët - SHFMU "...", në Gjakovë. Kjo vërtetohet edhe nga Kontrata e Punës e datës 05.10.2015.

Gjykata me shikimin në Vërtetim për ditët e pranisë në punë të lëshuar nga SHFMU "Yll Morina", me datë 08.11.2023, (të cilës ia dha besimin e plotë) ka vërtetuar faktin se për periudhën kohore prej datës 05.11.2021 e deri me datë 21.11.2022, paditësja ka gjithsejtë 187 ditë pune.

Ligji i Punës Nr.03/L-212, neni 90 par.5 e përcakton se "*Marrëveshja Kolektive vlen për ata punëdhënës dhe punëmarrës të cilët marrin përsipër detyrimet e përcaktuara me Marrëveshjen e tillë Kolektive*".

Kontrata Kolektive e Arsimit në Kosovë Nr.01B-105 e datës 22.01.2021, në nenin 35 par.7 përcakton: "*Të punësuarve u sigurohet kompensimi për ushqim gjatë punës, për ditët e pranisë në punë. Vlera e kompensimit të shpenzimit të ushqimit në punë, për një ditë pune, është 2 (dy) euro, për të punësuarit që kane marrëdhënien e punës primare në institucionet arsimore. Punëdhënësi i cili e ka të rregulluar ushqimin e të punësuarve përmes restaurantit apo kuzhinës ose në një formë tjetër, nuk ka obligim kompensimin për ushqim*".

Në pajtueshmëri me dispozitat e lartëcekura, gjykata gjeti se kërkesëpadia e paditëses është në tërësi e bazuar dhe vendosi si në pikën I të dispozitivit të këtij aktgjykimi, duke ia njohur të drejtën për kompensimin e shpenzimeve të ushqimit për periudhën prej datës 05.11.2021 e deri me datë 21.11.2022 në shumën prej 374.00 Euro, (187 ditë x 2euro = 374euro).

Gjykata me rastin e vendosjes (jashtë seancës gjyqësore) është bazuar në dispozitën e nenit 398 të LPK-së, e cila dispozitë e përcakton se: "*Kur gjykata, pasi t'i arrijë përgjigja në padi, konstaton se ndërmjet palëve nuk është kontestuese gjendja faktike, dhe se nuk ekzistojnë pengesa të tjera për dhënien e vendimit merititor, atëherë ajo, pa caktuar fare seancë gjyqësore, mund ta jep aktgjykimin me të cilën e pranon si të themeltë kërkesëpadinë*". Konform nenit 398

të LPK-së gjykata ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi dhe atë pa caktuar seancë gjyqësore, pasi që vlerësoi se në rastin konkret, kërkesëpadia paditëses është në tërësi e bazuar dhe vendosi si në dispozitiv të aktgjykimi, me arsyetimin se ka bazë në dispozitat e Ligjit të Punës Nr.03/L-212 dhe Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë Nr.01B-105 e datës 21.02.2021, ndërsa shuma e kompensimit bazohet në provat që gjenden në shkresat e lëndës.

Sa i përket kundërshtimeve tjera të të paditurës në përgjigje në padi, gjykata vlerëson se të njëjtat janë të pabazuara dhe nuk mbështeten në ndonjë bazë faktike apo juridike me të cilën do të duhej të refuzohej kërkesëpadia e paditëses. Në rastin konkret e paditura është punëdhënëse e paditëses (mësimdhënëse) dhe detyrohet që të përmbush detyrimet që dalin nga kjo kontratë, në raport me të punësuarit e saj në arsim. Pretendimet e të paditurës se kërkesa është parashkruar, nuk qëndrojnë, me arsyetimin se Kontrata Kolektive ka hyrë në fuqi 21.02.2021, ndërsa padia është parashtruar me datë 23.02.2024, kërkesëpadia është për periudhën prej datës 05.11.2021 e deri me datë 21.11.2022, pra brenda afatit prej 3 vitesh, ashtu siç e parasheh neni 87 i Ligjit të Punës.

Gjykata analizoi edhe pretendimet tjera të të paditurës, mirëpo vlerësoj se të njëjtat nuk kanë impakt në vendosjen ndryshe nga dispozitivi i këtij aktgjykimi.

Vendimin lidhur me kamatën prej 8 % gjykata e mori në kuptim të nenit 382 të LMD-së.

Gjykata vendimin mbi shpenzimet e procedurës kontestimore e mbështeti në nenin 452 të LPK-së, e që e paditura është obliguar që paditëses t'ia paguaj shpenzimet e procedurës në shumën prej 98.00 Euro dhe atë për përpilimin e padisë shumën prej 78€ dhe për taksë gjyqësore prej 20Euro, sipas Tarifës së Avokatëve – OAK.

Nga sa u tha më lart, e konform dispozitave ligjore të parapara me nenin 398 lidhur me nenin 142 të LPK-së, gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË

Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni Civil

C.nr.590/2024, datë 31.05.2024

G j y q t a r i,

Besmir JUNIKU

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi palët kanë të drejtë ankese në afat prej 7 (shtatë) ditëve nga dita e pranimit. Ankesa parashtrohet në këtë gjykatë, për Gjykatën e Apelit - Prishtinë.